



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:128832
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05554123

C.nr.1714/21

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve D.G., me numër personal ..., A.M. me numër personal ..., Q.R. me numër personal ..., S.A. me numër personal ..., A.S. me numër personal ... dhe G.R. me numër personal ..., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. Zejnije Bega nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.V. nga Ferizaj, për shkak të shpërblimit të licencimit, me vlerë të kontestit 17.870 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të datës 15.03.2024, më dt. 05.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve D.G., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R. ashtu që OBLIGOHET e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit që paditësve: D.G. në emër të kërkesës për kompensim të diferencës së pagës mbi bazën e licencimit të ia kompensojë shumën prej 3091€ (tremijë e nëntëdhjetë e një euro) për 56 muaj dhe atë nga data 10.06.2018-31.01.2023, paditësit Q.R. për periudhën e njëjtë shumën prej 3625€ (tremijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë euro) në emër të licencimit, paditësit S.A. për periudhën 01.06.2018-21.01.2021 shumën prej 1715€ (njëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë euro) në emër të licencimit, paditësit A.S. për periudhën 01.06.2018-31.01.2023 shumën prej 3091€ (tremijë e nëntëdhjetë e një euro) për 56 muaj në emër të licencimit, paditësit G.R. për periudhën 01.06.2018-31.01.2023 shumën prej 6348€ (gjashtëmijë e treqind e katërdhjetë e tetë euro) për 56 muaj, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (datë 22.06.2021) e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.M. për shpërblimin e licencimit për periudhën dhe atë nga data 01.06.2018-31.01.2023 për 56 muaj shumën prej 1327€ (njëmijë e treqind e njëzetë e shtatë euro), me kamatë ligjore prej 8%, duke

llogaritur nga dita e paraqitjes se padisë (datë 22.06.2021) e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

- III. OBLIGOHET e paditura Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit të ia kompensojë paditësve D.G., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R. shpenzimet procedurale në shumën prej 1228,80€ (njëmijë e dyqind e njëzetë e tetë euro e tetëdhjetë cent), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Fillimisht paditësi D.G. përmes të autorizuarës së saj av. Zejnije Bega nga Ferizaj më dt. 22.06.2021 ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate kundër të paditurës Komuna Ferizaj-DKA, për shpërblimin e licencimit. Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "A.A." në Ferizaj, në pozitën mësuese klase, me kontratë pune e licencuar – licenca nr. ..., datë 28.10.2016. E autorizuar e paditësës av. Zejnije Bega nga Ferizaj më dt. 28.09.2022 ka paraqitur në këtë gjykatë parashtrësë për zgjerimin e kërkesëpadiisë në kuptimin subjektiv, ashtu që tani e tutje si paditës do të jetë edhe A.M., Q.R., S.A., A.S., G.R., me kërkesat për paditësin D.G. në emër të kërkesës për kompensim të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit (licencimit) të ia kompensojë shumën prej 3091€ (tremijë e nëntëdhjetë e një euro) për 56 muaj dhe atë nga data 10.06.2018-31.01.2023, paditësit Q.R. për periudhën e njëjtë shumën prej 3625€ (tremijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë euro) në emër të licencimit, paditësit S.A. për periudhën 01.06.2018-21.01.2021 shumën prej 1715€ (njëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë euro) në emër të licencimit, paditësit A.S. për periudhën 01.06.2018-31.01.2023 shumën prej 3091€ (tremijë e nëntëdhjetë e një euro) për 56 muaj në emër të licencimit, paditësit G.R. për periudhën 01.06.2018-31.01.2023 shumën prej 6348€ (gjashtëmijë e treqind e katërdhjetë e tetë euro) për 56 muaj si dhe paditësit A.M. për periudhën dhe atë nga data 01.06.2018-31.01.2023 për 56 muaj shumën prej 1327€ (njëmijë e treqind e njëzetë e shtatë euro). E autorizuar e paditësve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadiinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe të detyrojë të paditurin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar-specifikuar.

E paditura Komuna Ferizaj-DKA, sipas fletëkthesës së dt. 30.10.2023 e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi dhe shkresat tjera por nuk ka dorëzuar përgjigje në padi në form të shkruar. Por i autorizuari i të paditurës av. komunal S.V. gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e pohoj ne teresi kerkesepadine e paditësve D.G., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R., me shumat e cekura si me larte kurse sa i perket paditesit A.M., pretendimet e tij nuk kane baze ligjore ngase paditesi hyn ne kategorine e punetoreve administrativ as me vendimin e Qeverise se Kosoves se vitit 2008 dhe as me Kontraten Kolektive te vitit 2017 dhe 2021 nuk eshte parapare qe punetoreve administrativ te u njihet e drejta e kualifikimit dhe e konsiderojme se nuk ka baze ligjore per kompensim.

Gjendja faktike e vërtetuar

Në seancën përgatitore të dt. 15.03.2024, gjykata fillimisht pasi ia dha mundësinë palës së paditur që të deklarohet rreth parashtrësës së të autorizuarës së paditësve për zgjerimin e padisë, i autorizuari i të paditurës nuk e kundërshton zgjerimin e padisë, ka nxjerrë aktvendim me të cilin lejohet parashtrësja për zgjerimin e kërkesëpadisë në aspektin subjektiv, tani e tutje si padites do te jete edhe: A.M., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R..

Gjatë kësaj seance përgatitore, i autorizuari i të paditurës e pohoj ne teresi kerkesepadine e paditesve D.G., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R., me shumat e cekura si me larte. Kurse e kontestoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë sa i perket paditesit A.M., pretendimet e tij nuk kane baze ligjore ngase paditesi hyn ne kategorine e punetoreve administrativ as me vendimin e Qeverise se Kosoves se vitit 2008 dhe as me Kontraten Kolektive te vitit 2017 dhe 2021 nuk eshte parapare qe punetoreve administrativ te u njihet e drejta e kualifikimit dhe e konsiderojme se nuk ka baze ligjore per kompensim.

Andaj gjykata me propozimin e paleve ndergjyqese qe te lexohen provat vetem per paditesin A.M. meqenese per paditesit e tjere u pohua kerkesepadia nga ana e te paditurit dhe nuk jane objekt shqyrtimi sepse nuk i konteston e paditura, i ka administruar provat vetëm për këtë paditës.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Diplome e Kolegjit AAB Fakulteti Juridik, i dates 26.10.2009, Lista e pagave e muajit mars e vitit 2019, Kontrate pune e dates 23.01.2017.

Meqenëse kërkesëpadia e paditësve D.G., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R. është pohuar në tërësi nga ana e të autorizuarit të paditurës në seancën gjyqësore, gjykata konform nenit 148.1 të LPK në të cilin parashihet se: “Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).” vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Arsyet për refuzimin e padisë së paditësit A.M.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit A.M. është e pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga Diploma e UP “H.P.”, Fakulteti Juridik e dt. 26.10.2009, nr. .../09, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.M. ka mbaruar studimet në Universitetin e Prishtinës dhe ka marrë kualifikimin Baçelor i shkencave, BSc në Juridik.

Nga Lista e pagave të lëshuar nga BRK e datës 31.03.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.M. pagën bruto e ka 478.16 euro, pagën neto e ka 428.86 euro dhe për shkak të kualifikimit i është paguar shuma prej 55,35 euro.

Nga Kontrata e punës nr. prot. .../2017, e dt. 23.01.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi A.M. ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, vendi i punës Zyrtar Administrativ (Sekretar), në SHFMU B.R., K..

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konstatoi se themelësia e kërkesëpadiës për paditësin A.M. nuk del nga faktet e treguara në padi, pasi që nga provat e ofruara nga pala paditëse, vërtetohet fakti se me rastin e ushtrimit të padisë nuk ka qenë i pajisur me licencë, e në rastin konkret që të kërkohet kompensimi, ashtu siç parashihet me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 dhe asaj të vitit 2021, si kusht bazë është që pala të jetë e pajisur me licencë, që në rastin konkret paditësit i mungon. Kjo gjykatë sqaron se, bazuar në vendimin, nr.01/33, i datës 29.08.2008 e Qeverisë së Republikës së Kosovës ku në pikën 1 është vendosur që: Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët

(zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licensimit, ndërsa pika 4 ka përcaktuar se: “Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”, në rastin konkret paditësit A.M. një e drejtë për kompensim të diferencës në pagë në emër të licensimit do të i takonte sikur i njëjti të ishte i pajisur me licencë (shih aktgjykimet Ac.nr.7047/2022, të dt. 26.03.2024 dhe Ac.nr.7048/2022, të dt. 16.02.2024 të Gjykatës së Apelit e Kosovës në rastet e ngjajshme). Paditësi me asnjë provë konkrete valide nuk ka arritur ta provoj të drejtën e tij të pretenduar me kërkesëpadi, për kompensimin e diferencës në pagë në bazë të licensimit pasi që i njëjti nuk posedon licencë në bazë të së cilës do të mund të kërkonte kompensimin e kërkuar me padi. Në këtë drejtim, me të drejtë konstatohet se pala paditëse nuk ka arritur të provojë faktin se të njëjtës i takon kompensimi i kërkuar në bazë të licensimit pasi që licenca i mungon, për çka edhe në këtë rast nuk ka mundur të gjen zbatim dispozita e nenit 7 e Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017 e as ajo e vitit 2021.

Andaj, pretendimet e paditësit mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të gjykatës, nuk qëndrojnë dhe i refuzoi si të tilla.

Gjykata i mori për bazë të gjitha pretendimet e paditësit A.M., por të cilat nuk kishin ndikim për të vendosur ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale

Gjykata duke pas parasysh suksesin në procedurë të paditësve D.G., Q.R., S.A., A.S. dhe G.R. dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së ka aprovuar në tërësi kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga e autorizuar e paditësve av. Zejnije Bega, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë nga avokati në shumën prej 624€, taksa gjyqësore për padi në shumën prej 101€ dhe përfaqësimi në seancë nga avokati në shumën prej 811€, gjithsej shuma prej 1536€, mirëpo meqenëse e autorizuar e paditësve i kërkoi – 20% të këtyre shpenzimeve në bazë të kalkulimit dhe kërkesës aprovohet shuma prej 1228.80€ në formë të shpenzimeve procedurale, krejt kjo në kuptim të

nenit 2.1 të LPK. Lidhur me lartësinë e taksës gjyqësore gjykata vendosi konform nenit 12.1 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore të KGJK.

Nga të cekurat më lartë, e konform nenit 143 të LPK, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.1714/21, datë 05.04.2024

Gjyqtari,
Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.